



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 1068 prot.

Shkodër me, 09/03/2020

V E N D I M

Nr. 141, datë 09.03.2020

"PËR MIRATIMIN E PEZULLIMIT TË PROÇESIT MËSIMOR NË USH 'LUIGJ GURAKUQI' PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë; të Urdhërit nr.135, datë 09.03.2020 "Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19" të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; dhe në mbështetje të Statutit të USH, Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" në mbledhjen e tij të datës 09.03.2020

V E N D O S I:

1. Miratimin e pezullimit të procesit mësimor në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" nga data 09.03.2020 deri me 23.03.2020.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Administratorja dhe Dekanët e fakulteteve për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI I SENATIT

Prof. dr. Adem BEKTESHI

